

LIGJ
Nr.8321, datë 2.4.1998

PËR POLICINË E BURGJEVE

(Ndryshuar me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001; 9375, datë 21.4.2005)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I:

I. DETYRAT DHE FUNKSIONET E POLICISË SË BURGJEVE

Neni 1

(Ndryshuar paragrafi i parë, dytë dhe katërt me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001)

Policia e Burgjeve është strukturë e armatosur në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Policia e Burgjeve i kryen detyrat e veta mbështetur në këtë ligj dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e saj.

Policia e Burgjeve i realizon detyrat dhe funksionet e saj, duke respektuar të drejtat dhe liritë e garantuara me ligj të personave të dënuar me burgim.

Policia e Burgjeve gëzon të gjitha të drejtat që parashikon ligji nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Neni 2

Organizimi dhe rregullat e brendshme

Organizimi i brendshëm i Policisë së Burgjeve, kompetencat, rregullat e shërbimit dhe të disiplinës dhe përgjegjësia përkatëse përcaktohen me rregulloren e brendshme të Policisë së Burgjeve, miratuar nga ministri i Drejtësisë.

Neni 3

Detyrat e Policisë së Burgjeve

(Shtuar paragraf me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001; ndryshuar shkronja “ç” e shtuar shkronjat “e” dhe “ë” me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Policia e Burgjeve garanton ruajtjen e vendeve të vuajtjes së dënimit me burgim dhe zbatimin e rregullave të brendshme në to.

Për realizimin e funksioneve të mësipërme, policia e burgjeve:

a. siguron ruajtjen perimetrike, si dhe zbaton rregullat e hyrjes dhe të daljes në institucionet e vuajtjes së dënimit;

b. siguron zbatimin e rregullave të brendshme dhe të sigurisë brenda këtyre institucioneve;

c. garanton realizimin e veprimtarive të të dënuarve, vëzhgon dhe siguron sjelljen e tyre ditore në përputhje me rregulloren;

ç. merr masa për shoqërimin dhe sigurimin e ruajtjes fizike të të paraburgosurve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale penale, të urdhëruara nga gjykata ose prokurori, si dhe shoqëron të dënuarit gjatë transferimeve, në lejet speciale dhe në lëvizjet jashtë institucionit;

d. siguron ruajtjen e të dënuarve në spitale ose qendra të tjera mjekësore;

dh. në raste të jashtëzakonshme, fatkeqësish, fenomeneve natyrore etj. vihet në dispozicion të drejtorisë së institucionit për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të të dënuarve dhe për të parandaluar dëmet materiale.

e) kontrollon për sende të ndaluara mjediset e brendshme dhe të jashtme, si dhe personat që hyjnë në regjimin e burgut;

ë) Policia e Burgjeve, në përputhje me urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Drejtësisë, kryen edhe detyra të tjera për garantimin e rendit, për paprekshmërinë e objekteve dhe regjimin e lëvizjeve në institucionet e varësisë të Ministrisë së Drejtësisë.

Në raste të veçanta, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, veprimtaria e saj mbështetet nga Policia e Shtetit.

KREU II STRUKTURA DHE ORGANIZIMI

Neni 4

Struktura e Policisë së Burgjeve

(Shtuar pika 5 me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001; ndryshuar fjalë në pikën 2 dhe shfuqizuar pikat 3, 4 dhe 5 me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Policia e Burgjeve përbëhet nga:

1. Drejtoria e Policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
2. Punonjësit e policisë në burgje.
3. Shfuqizuar.
4. Shfuqizuar.
5. Shfuqizuar.

Veprimet financiare, ekonomike, shëndetësore dhe nevojat materiale e teknike për shërbimin, plotësohen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 5

Detyrat funksionale

(Ndryshuar fjalia e parë shkronja “b” dhe “d” me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Funksionet e punonjësve të Policisë së Burgjeve janë:

- a) Drejtor i Drejtorisë së Policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;
- b) shef sektori në Drejtorinë e Policisë së Burgjeve;
- c) specialist i policisë në Drejtorinë e Policisë së Burgjeve;
- ç) shef i policisë në institucionet e vuajtjes së dënimit;
- d) specialist i regjimeve në institucionet e vuajtjes së dënimit;
- dh) specialist i efektivit të policisë në institucionet e vuajtjes së dënimit;
- e) specialist i shërbimit të informacionit në institucionet e vuajtjes së dënimit.

Neni 6

Raportet hierakike dhe funksionale

Punonjësit e Policisë së Burgjeve janë të detyruar të zbatojnë urdhrat e dhënë nga eprorët sipas shkallës funksionale dhe në raporte të barabarta sipas hierarkisë së gradës.

Urdhrat duhet të jepen në përputhje me detyrën funksionale e në realizim të saj, si dhe të mos jenë në kundërshtim me ligjin dhe me dinjitetin e personit të cilit i drejtohen.

Në mungesë të eprorit të drejtpërdrejtë, në raste urgjente dhe kur nuk ka mundësi të komunikohet me eprorë më të lartë, funksionari me gradë më të lartë ka të drejtën e urdhrat ndaj funksionarëve të barabartë ose më të ulët në gradë.

Neni 7

Mënyra e zbatimit të urdhrat

Urdhri me shkrim që konsiderohet i paligjshëm duhet të zbatohet kurdoherë, me përjashtim të rastit kur është haptazi i kundërligjshëm.

Për urdhrat verbalë, që konsiderohen të paligjshëm, është e detyrueshme dhënia me shkrim kur kërkohet nga zbatuesi dhe, kur kjo është e pamundur, jepet pas zbatimit të tij.

Në të gjitha rastet, marrësi i urdhrat duhet të njoftojë sa më parë organet eprore për konstatimin e paligjshmërisë.

Për urdhrin e dhënë mban përgjegjësi në çdo rast urdhërdhënësi, si dhe zbatuesi i urdhrat, kur nuk ka paraqitur kundërshtimet si më sipër.

Për zbatimin e urdhrat haptazi të kundërligjshëm, mban përgjegjësi në çdo rast edhe zbatuesi.

Neni 8

Mbajtja dhe përdorimi i armatimit

Armatimi nuk mund të mbahet në mjediset e brendshme të burgut të destinuara për qëndrim dhe përdorim nga të dënuarit, por vetëm në mjedise jashtë tyre dhe në shërbimet e shoqërimit jashtë institucionit.

Llojet, normat, rastet dhe mënyra e vënies në përdorim të armatimit vetjak, bëhet vetëm në rastet e parashikuara me ligjin “Për Policinë e Shtetit”.

Mjetet e tjera të forcës vihen në përdorim vetëm me urdhër të drejtorit të Policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve ose në raste të jashtëzakonshme me urdhër të shefit të Policisë së Institucionit.

Neni 9

Orari i shërbimit

(Shfuqizuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Orari i shërbimit të efektivit të Policisë së Burgjeve është i njëjtë me atë të Policisë së Shtetit dhe i organizuar në turne sipas kërkesave të shërbimit.

Efektivi i Policisë së Burgjeve, kur nuk paraqitet zëvendësuesi ose e kërkojnë nevojat e shërbimit, është i detyruar të vazhdojë shërbimin edhe pas mbarimit të orarit të caktuar, me të drejtën e kompensimit, me pushim suplementar dhe në pamundësi, me pagë sipas ligjit.

Neni 9/1

Koha e punës dhe e pushimit

(Shtuar me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Koha javore e punës dhe e pushimit, si dhe pushimi vjetor për punonjësit e Policisë së Burgjeve njësohen me ato të nëpunësve të tjerë të administratës publike. Kur për arsye pune

dhe shërbimi, pushimi vjetor nuk jepet brenda vitit, punonjësi ka të drejtën e kryerjes së tij jo më vonë se muaji mars i vitit pasardhës. Në të kundërt, bëhet kompensimi në vlerë, sikurse edhe për mbikohën e punës dhe të shërbimit, gjatë kohës javore të punës, në ditët e pushimit ose në festat zyrtare.

Neni 10

Qëndrimi i përhershëm dhe i përkohshëm në institucion

Efektivi i policisë, si rregull, duhet të banojë në afërsi të Institucionit, përveç kur çmohet ndryshe në rastin e emërimit të tij.

Në raste të veçanta ose situata të jashtëzakonshme dhe me miratim të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, lejohet banimi i përkohshëm, jo familjarisht, i pjesëtarëve të efektivit brenda institucionit në mjedise të veçanta.

Neni 11

Organikat dhe gradat

(Ndryshuar me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001; ndryshuar paragrafi i 6 dhe shtuar paragraf me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Policia e Burgjeve është pjesë përbërëse e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e miratuar nga Kryeministri me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë.

Efektivi i Policisë së Burgjeve përbëhet nga punonjës të rolit bazë, të mesëm, të lartë dhe madhor.

Gradat e tyre janë të njëjta me ato të Policisë së Shtetit.

Gradimi i punonjësve të rolit bazë dhe të mesëm bëhet nga Drejtori i Policisë së Burgjeve.

Gradat e punonjësve të rolit të lartë jepen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, kurse gradat e rolit madhor jepen me dekret të Presidentit të Republikës, në bazë të propozimit të Ministrit të Drejtësisë.

Për gradimin e punonjësve të rolit bazë e të mesëm, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, funksionon komisioni këshillimor, përbërja dhe organizimi i të cilit caktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Për gradimin e punonjësve të rolit të lartë dhe madhor, pranë Ministrit të Drejtësisë funksionon komisioni këshillimor, përbërja dhe organizimi i të cilit caktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 12

Paga

(Shtuar fjalë me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Pagat, shtesat dhe shpërblimet mbi pagën e policisë së burgjeve janë të njëjtë me atë të Policisë së Shtetit sipas funksionit, gradës dhe kriterëve të tjera përkatëse të përcaktuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit.”.

KREU III

EMËRIMI, SHKARKIMI DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 13

Emërimet dhe gradimet

(Ndryshuar fjalë dhe fjalë e fundit me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001)

Pranimi i punonjësve të rolit bazë në efektivin e Policisë së Burgjeve bëhet nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve nëpërmjet një konkursi të hapur sipas kriterëve të miratuara nga ministri i Drejtësisë, në të cilin mund të marrin pjesë qytetarët shqiptarë që kanë të dhënat e mëposhtme:

1. Të jenë në moshën 20-35 vjeç.
2. Të kenë të dhënat e nevojshme fizike e psikike për të kryer shërbimin.
3. Të kenë arsim të mesëm.
4. Të mos kenë qenë të dënuar penalisht dhe të jenë me qëndrim të mirë moral.

Fituesit e konkursit emërohen punonjës policie të rolit bazë. Titullimi dhe gradimi i tyre bëhet pas mbarimit të kursit përkatës në Shkollën e Policisë së Burgjeve.”

Neni 14

Emërimet e oficerëve

(Ndryshuar fjalë dhe paragrafi i dytë me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001; ndryshuar fjalë me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Emërimi i punonjësve të tjerë, me përjashtim të drejtorit të Policisë së Burgjeve, bëhet vetëm pasi t'i jenë nënshtruar testimit për aftësi profesionale.

Emërimi dhe shkarkimi në funksionet, sipas shkronjave “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të nenit 5 të këtij ligji bëhen nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve me propozimin e Drejtorit të Policisë së Burgjeve, kurse sipas shkronjave “b” dhe “c” të nenit 5 të këtij ligji bëhen nga Ministri i Drejtësisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Mënyra e organizimit të testimit, kriteret e vlerësimit dhe përbërja e komisioneve përcaktohen nga ministri i Drejtësisë.

Neni 15

Emërimi i drejtorit të Policisë së Burgjeve

(Ndryshuar fjalë dhe fjalia e fundit me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001)

Drejtori i Policisë së Burgjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve zgjidhet ndërmjet punonjësve të efektivit të Policisë së Burgjeve, Policisë së Shtetit ose nga ushtria, me gradë jo më të ulët se punonjës së rolit të lartë ose të barasvlefshëm me të.

Drejtori i Policisë së Burgjeve emërohet nga Ministri i Drejtësisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 16

Kriteret e dhënies së gradave

(Ndryshuar me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001)

Për dhënien ose heqjen e gradave zbatohen të njëjtat kriterë që përcaktohen në ligjin nr.8643, datë 20.7.2000 “Për gradat në Policinë e Shtetit.

Neni 17

Masat disiplinore

(Ndryshuar fjalë dhe shtuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Efektivi i Policisë së Burgjeve kur nuk zbaton detyrat e shërbimit ose shkel rregullat e parashikuara në këtë ligj, në rregulloren e brendshme ose në akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me detyrën dhe kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, ndëshkohet me masat e mëposhtme:

1. Vërejtje.
2. Vërejtje me paralajmërim.
3. pezullim nga shërbimi pa të drejtë page për një kohë deri në 3 muaj.
4. Ulje në gradë ose në funksion.
5. Transferim në një institucion tjetër.
6. Largim nga detyra.

Masat e mësipërme jepen si rregull në mënyrë të shkallëzuar si dhe në bazë të rëndësisë së shkeljes dhe të pasojave të ardhura ose që mund të vinin brenda muajit nga dita e konstatimit dhe jo më vonë se 1 vit nga kryerja e saj.

Për secilën nga masat disiplinore të mësipërme zbatohen kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Disiplinës të Policisë së Burgjeve, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Për secilën nga masat disiplinore të mësipërme zbatohen kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Disiplinës të Policisë së Burgjeve, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 17/1

Lirimi nga detyra

(Shtuar me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve lirohet nga detyra në rastet kur:
 - a) ka mbushur moshën për pension;
 - b) bëhet i paafte nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi 6 muaj, me ose pa vendim të komisionit mjekësor;
 - c) me kërkesë të tij, pasi ka plotësuar detyrimet sipas dispozitave ligjore në fuqi;
 - ç) për arsye të ristrukturimit dhe shkurtimit të funksionit organik.
2. Në rastet kur punonjësi lirohet nga detyra, sipas shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, kur ai merr riaftësimin shëndetësor, ose kur krijohen vende dhe funksione të reja, ai gëzon të drejtën e kërkesës dhe të përzgjedhjes me përparësi për t’u punësuar, në mbështetje të formimit, kualifikimit dhe vjetërsisë që kishte në shërbim në Policinë e Burgjeve përpara lirimit nga detyra.

Neni 17/2

Largimi nga detyra

(Shtuar me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

- Punonjësi i Policisë së Burgjeve largohet nga detyra në rastet kur:
- a) është pranuar në punë në kundërshtim me kriteret e parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre;
 - b) shkel rëndë ose në mënyrë të përsëritur rregullat e disiplinës dhe të shërbimit pa u shlyer masat disiplinore të dhëna më parë;
 - c) është dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - ç) nuk paraqitet në detyrë për më shumë se 3 ditë rresht pa shkaqe të arsyeshme.

Neni 18

Komisioni disiplinore

(Ndryshuar me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001; ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Procedimi disiplinor

1. Masat disiplinore jepen në bazë të Rregullores së Disiplinës të Policisë së Burgjeve,

të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, dhe, në çdo rast, i njoftohen punonjësit të policisë. Në çdo rast punonjësi detyrohet të zhdëmtojë dëmin e shkaktuar sipas dispozitave në fuqi.

2. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Vendimi për marrjen e masës disiplinore i njoftohet me shkrim të interesuarit dhe shënohet në dosjen vetjake.

3. Dhënia e masave disiplinore dhe shqyrtimi i tyre bëhet sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

Neni 18/1

Ankimi

(Shtuar me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001; ndryshuar pika 6 dhe shtuar pika 7 me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

1. Në çdo rast punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit është marrë masë disiplinore, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim brenda 10 ditësh tek titullari i institucionit.

2. Kur titullari i institucionit e gjykon të pabazuar dhënien e masës disiplinore, nuk e miraton atë. Në rast të miratimit të masës disiplinore, punonjësi i policisë ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim, brenda 10 ditëve te Komisioni Disiplinor. Titullari i institucionit mund të vendosë pezullimin nga detyra të punonjësit të policisë.

3. Komisioni Disiplinor, kur e gjen të bazuar, vendos lënien në fuqi të masës disiplinore, ose i propozon titullarit të institucionit për ta rishikuar masën e dhënë.

4. Vendimi i Komisionit Disiplinor për lënien në fuqi të masës disiplinore është i formës së prerë, me përjashtim të masave disiplinore të parashikuara në pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 17 të këtij ligji, që hyjnë në fuqi me miratim të organit përkatës për emërimin ose dhënien e gradës përkatëse. Miratimi jepet brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit nga Komisioni Disiplinor.

5. Për masat disiplinore të ankimuara, afatet e shuarjes fillojnë nga data kur vendimi i titullarit ka marrë formë të prerë.

6. Për dhënien e masës disiplinore, për punonjësin e rolit bazë, ngrihet Komisioni Disiplinor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Përbërja dhe funksionimi i këtij Komisioni caktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

7. Për dhënien e masës disiplinore, për punonjësin e rolit të mesëm dhe të lartë, si dhe për masën e largimit nga detyra të punonjësit të rolit bazë, ngrihet Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Drejtësisë. Përbërja dhe funksionimi i këtij Komisioni caktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 18/2

Heqja dhe shuarja e masës disiplinore

(Shtuar me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001; ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

1. Gjatë periudhës në të cilën ndaj punonjësit është marrë masë disiplinore, ndërpritet ecja e afateve që lidhen me fitimin e të drejtave të parashikuara për punonjësin e Policisë së Burgjeve, duke përjashtuar vjetërsinë në shërbim.

2. Në raste të veçanta, kur i ndëshkuari kryen akte përkushtimi në detyrë, heqja e masës disiplinore mund të bëhet nga titullari para afatit.

3. Masat disiplinore “vërejtje” ose “vërejtje me paralajmërim” shlyhen me kalimin e 6 muajve nga data e dhënies së tyre.

Masat e tjera shlyhen me kalimin e 1 viti nga data e dhënies së tyre, me përjashtim të masës “largim nga detyra”.

Për masat disiplinore të ankimuara, afatet e shuarjes llogariten nga data që vendimi i titullarit ka marrë formë të prerë.

Neni 18/3

Ankimi në gjykatë

(Shtuar me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001)

Kundër vendimit të formës së prerë për dhënien e masave disiplinore, të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji, mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 328 të Kodit të Procedurës Civile.

KREU IV

FLAMURI, UNIFORMA DHE SHËNJAT DALLUESE

Neni 19

Policia e Burgjeve ka flamurin e saj

Efektivi i Policisë së Burgjeve pajiset me uniformë të veçantë sipas destinacionit dhe stinës së përdorimit.

Në uniformë është e detyrueshme vendosja e gradave dhe shenjave dalluese dhe identifikuese, me përjashtim të rasteve të veçanta.

Flamuri, uniforma dhe shenjat dalluese dhe identifikuese dhe kriteret e mbajtjes së tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 20

Punonjësit civilë

(Ndryshuar me ligjin nr.8757, datë 26.3.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9375, datë 21.4.2005)

Punonjësit e administratës civile të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët nuk bëjnë pjesë në strukturat e Policisë së Burgjeve, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

Neni 21

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë të nxjerrin aktet e nevojshme në zbatim të këtij ligji.

Neni 22

Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen. Rregulloret e brendshme mbeten në fuqi për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me këtë ligj, deri në miratimin e rregullores së brendshme Policisë së Burgjeve.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2046, datë 15.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**